



Perqasja Rajonale per Reduktimin e Stoqeve (RASR)

Njoftim per shtyp

Çfarë është RASR?

Iniciativa Rajonale për Reduktimin e Stoqeve (RASR) është një përqasje rajonale aftagjatë dhe e koordinuar që adreson rrezikun që paraqesin stoqet e tepërta, të paqëndrueshme, të hapur dhe të pasigurta, ose në tërësi rrezikun që paraqesin stoqet e armëve konvencionale dhe municionet. RASR inkurajon qeveritë e vendeve të rajonit që përballen më një problem të tillë dhe organizmat kryesore që të zhvillojnë një përqasje rajonale proaktive dhe të koordinuar për sigurimin dhe shkatërrimin e armëve të vogla dhe të lehta duke ngritur kapacitetet e nevojshme kombëtare, shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe nxjerrjen e mësimave si dhe sinkronizimin e burimeve në funksion të maksimizimit të efikasitetit në këtë proces. Qëllimi kryesor i kësaj iniciative (RASR) është për të parandaluar shpërthimet katastrofike ose shmangien e destabilizimit që mund të vijë nga armatimi dhe municionet konvencionale.

Për më shumë detaje, vizitoni faqen www.rasrinitiative.org ose email info@rasrinitiative.org.]

Pse është Shqipëria angazhuar në këtë iniciativë rajonale (RASAR) ?

Shqipëria është krenare që merr pjesë në Iniciativën për Përqasjen Rajonale për Reduktimin e Stoqeve. Kjo është një mundësi joformale por serioze për ushtarakët e lartë dhe ekspertët e municioneve nga të gjithë vendet e Evropës Juglindore që herë pas here të mbledhen së bashku për të shkëmbyer idetë dhe diskutuar sfidat e përbashkëta në drejtim të reduktimit të sasive të mëdha të municioneve të trashëguara nga epoka e Luftës së Ftohtë që nuk kanë më vlerë ushtarake, por që bëhen gjithnjë e më të rrezikshme dhe kanë një kosto të lartë financiare për ruajtjen dhe depozitimin e tyre. Këto diskutime në kontekstin e përqasjes rajonale për reduktimin e stoqeve (RASR) jo vetëm që ndihmojnë për të shkëmbyer njohuritë e dobishme teknike midis ushtarakëve në rajon, por edhe kontribuojnë në ndërtimin e mirëbesimit reciprok rajonal

Pse Shqipëria është vendi organizator i këtij aktiviteti?

Shqipëria është krenare që për herë parë është vendi ku organizohet zhvillimi i Seminarit të 5-të të kësaj iniciative rajonale RASR. Ministria e Mbrojtjes ndjehet e vlerësuar që pjesëmarrësve në këtë konferencë u jepet mundësia për të vizituar një nga uzinat ku realizohet demontimi industrial i municioneve siç është - ULP Mjekës, ku ata mund të shikojnë vetë se si Shqipëria është duke u përballur me trajtimin e stokut të madh të municioneve të vjetra. Ne shpresojmë se disa nga proceset që ata do të vëzhgojnë në ULP Mjekës, do t'u japë atyre ide të dobishme për ti implementuar në vendet e tyre. Ne vlerësojmë se kemi kapacitete të lira (të mjaftueshme) dhe të papërdorura në ULP Mjekës, që mund të përdoren për demilitarizimin e municioneve të tjera të tepërta nëse do të jete e nevojshme dhe kërkohet.

http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/G-Issue-briefs/SAS-RASR-IB1_SE-European-Surplus-Arms-ALB-rev.pdf

Reduktimi i stoqeve në Shqipëri;

Çfarë Shqipëria ka bërë në fushën e çmilitarizimit dhe reduktimin e stoqeve është kryesisht rezultat i angazhimit të vet kombëtar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Pas vendosjes së regjimit demokratik, Qeverisë së Shqipërisë i'u desh të përballej me një stok të madh të armatimit, municioneve dhe pajisjeve të tjera ushtarake të shpërndarë në shumë magazina të vogla në të gjithë territorin e vendit.

Shqipëria u çlirua nga armët kimike që në vitin 2007. Me ndihmën e OSBE-së, Ministria e Mbrojtjes është e angazhuar në një projekt tjetër për të eliminuar në mënyrë të sigurt, stokun e mbetur të kimikateve të dëmshme industriale dhe ushtarake.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, Shqipëria ka shkatërruar pjesën më të madhe të arsenalit të armëve siç janë: tanket, armët e artilerisë dhe sistemet e armëve të rënda, si dhe mbi njëqind mijë armë të vogla dhe të lehta të këmbësorisë.

Kush janë problemet kryesore të municioneve të vjetra në Shqipëri?

Me përpjekjet e bëra për pastrimin e zonave të kontaminuar me municione të pa-plasura (HOTSPOTS) në pjesë të ndryshme të vendit dhe përpjekjet e saj për demilitarizimin në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme të municioneve të tepërta, në ULP Mjekës dhe në uzinat e tjera në Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes ka demonstruar angazhimin e saj për të garantuar sigurinë e qytetarëve shqiptarë dhe reduktimin e shpenzimeve për personelin ushtarak të angazhuar në ruajtjen e depove të stoqeve që që nuk kanë vlerë ushtarake si dhe ka treguar se Shqipëria është një anëtare e denjë dhe e përgjegjshme e Aleancës së NATO-s.

Pastrimi zonave të kontaminuar me municione të pa-plasura (HOTSPOTS) ;

Që nga shpërthimi në Gërdec në vitin 2008, me ndihmën bujare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të dhënë nëpërmjet organizatës me bazë në Slloveni, ITF Rritja e Sigurisë Njerëzore (ish Fondi Ndërkombëtarë i Besimit për Çminimin dhe Asistencë për Viktimat e Minave), pastrimi i zonës së shpërthimit është në përfundim e sipër dhe

do të jetë gati për t'u vënë në dispozicion të popullsisë lokale. Të gjitha gropat (krateret) e mëdha që u krijuan nga shpërthimet e fuqishme, janë pastruar nga municionet e paplasura dhe janë rimbushur duke bërë të mundur kthimin e zonës në gjendjen e mëparshme. Gjithashtu, pjesa më e madhe e sipërfaqes përreth zonës së shpërthimit është pastruar. Ne falënderojmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën e dhënë për të arritur në këtë stad të avancuar për rehabilitimin e plotë të zonës së Gërdecit www.itf-fund.si

Një pjesë e fondit prej \$ 3.6 milion USD që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë investuar vetëm në vitin 2011 për pastrimin e zonës së Gërdecit, është përdorur gjithashtu për të mbështetur pastrimin nga municionet e paplasura në dy zona përfshirë edhe një nga poligonet e asgjësimit (ish poligon i qitjes artilerisë). Kjo është realizuar nëpërmjet një grandit të qeverisë amerikane dhënë ITF, e cila nën-kontraktat për këtë detyrë kompaninë Sterling International, dhe kjo e fundit nën-kontraktat Danish Church Aid (DCA). Ne e vlerësojmë asistencën e Qeverisë Amerikane dhe menaxhimin e shkëlqyer të projektit si dhe punën e vështirë që është bërë nga ITF, Sterling, DCA, dhe punonjësit shqiptarë me eksperiencë të DCA-së.

Po në lidhje me Asgjësimin Industrial të municioneve të tepërta?

Procesi i demilitarizimit të municioneve të tepërta mori vëmendje të veçantë gjatë vitit 2009. U hartua dhe miratua Plani i Veprimit për eliminimin e municioneve të tepërta dhe Qeveria Shqiptare ka alokuar çdo vit të rreth 3 milionë euro në mbështetje të këtij procesi, përveç fondeve të marra nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria arriti të asgjësojë më shumë se 6 mijë ton municione në vitin 2009, mbi 20 mijë ton në vitin 2010 dhe më shumë se 26 mijë ton në vitin 2011. Synimi i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2012 është që të asgjësojë rreth 26.000 ton, ndërkohë që vetëm gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 Shqipëria ka eliminuar 6,500 ton. Në total gjatë periudhës 2009 - Prill 2012, Shqipëria ka shkatërruar mbi 60.000 ton municione të tepërta dhe pjesa tjetër e mbetur do të shkatërrohet deri në fund të vitit 2013.

Në gjithë procesin e demilitarizimit, çelësi i suksesit të Shqipërisë ka qenë bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndihma e dhënë nga Qeveria e SHBA-së, NAMSA, OSBE nëpërmjet fondeve të siguruara nga qeveria Gjermane, Finlanda, Danimarka dhe vende të tjera. Janë zhvilluar dy konferenca të mëdha të donatorëve për demilitarizimin e municioneve, në Bruksel në Mars të vitit 2010 dhe e dyta në Tiranë, në Tetor 2011.

Nëpërmjet një sërë Grandesh dhënë Agjencisë për Mbështetje dhe Furnizim e NATO-s (NAMSA), Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë mundur që Shqipëria vetë të asgjësojë disa ton municione të tepërta dhe të paqëndrueshme në ULP Mjekës. Gjatë dy viteve të fundit, Shtetet e Bashkuara kanë shpenzuar 4.000.000 USD vetëm në ULP Mjekës, për të ndihmuar Shqipërinë në asgjësimin e municioneve të saj të vjetra dhe municioneve të pavlefshme të kohës së Luftës së Ftohtë. Ky proces e ka bërë Shqipërinë më të sigurt dhe deri në fund të këtij projekti, Shqipëria do të jetë në një pozicion edhe më të mirë në lidhje me eliminimin e municioneve të tepërta. Ky projekt ka ndihmuar edhe nga pikëpamja sociale në punësimin e punëtorëve civilë.

Në sajë të asistencës teknike të dhënë nga NAMSA, uzina e ULP Mjekës ka zhvilluar ekspertizën, infrastrukturën dhe krijuar potencialet e nevojshme për plotësimin e nevojave të demilitarizimit të municioneve. Arritjet e deritanishme të ULP Mjekës janë:

- **601 ton municione të asgjësuar, financuar nga projekti në tre muaj Janar - Mars 2012**
- **5,509 ton municione të asgjësuar në total, financuar nga projekti që prej fillimit të projektit në Janar 2011**
- **Mbi 10 Milion cope mina kundër tanke, predha mortajash dhe artilerie si dhe municione të vogla, janë demilitarizuar që nga muaji Janar 2011**

http://www.namsa.nato.int/Demil/news_e.htm

Pikë kryesore dhe kontakti për asistencën e dhënë nga Shtetet e Bashkuara për shkatërrimin e armëve konvencionale për Shqipëri ka qenë dhe vazhdon të jetë Zyra për Reduktimin dhe Mbrojtjen nga Armët pranë Byrosë për Marrëdhëniet Politiko-Ushtarake të Departamentit Amerikan të Shtetit. (www.state.gov/t/pm/wra).

Informacione dhe detaje të tjera janë në dispozicion në materialet bashkëlidhur:

1. Projekti Fondit të Besimit të NATO-s (të dhëna dhe informacione shtesë NAMSA-s)
2. ITF
3. Projekti i DCA
4. Të dhëna dhe informacione shtesë të RASR